



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

A nr. 61/2011

Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP), në panelin e përbërë nga, Rafet Haxhaj kryesues, Ferit Osmani dhe Nehat Idrizi, duke vendosur përkitazi me ankesën e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK) me seli në Prishtinë, paraqitur kundër disa militanteve të PDK-ës, për shkak të kërcënimit gjatë procesit të votimit, në seancën e panelit të mbajtur me 13.01.2011, mori këtë:

## V E N D I M

**REUZOHET** si e pabazuar ankesat e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosoves (LDK).

## A r s y e t i m

PZAP ka pranuar një ankesë me datë 010.01.2011, nga LDK në të cilën theksohet se ne fshatin Runik komuna e Skenderajit ne shkollën fillore Shote Galica ne vv 02R rrëth orës 17 e 20 min kanë hyrë militantet e PDK-ës dhe kane votuar pa u kontrolluar me llampa, pa letërnjoftim dhe asnjë kontroll tjetër. Ne të njëjtën qendër te votimit nr vv 01R vëzhguesi i LDK është kërcënuar dhe share ,se nëse shënon ndonjë vërejtje për parregullsit do ta largojnë nga vendvotimi.Në këtë vendvotim poashtu janë vërejtur persona qe kane votuar disa herë.

Ndërsa ne shkollën fillore Hamez Jashari ne Skenderaj ne klase 03R pas orës 15:00 militantet e PDK-ës kane hyre dhe kane votuar disa here pasi qe komisionerja e cila kontrollonte librin e nënshkrimeve lejonte dhe kishte marrëveshje me këta persona. Poashtu në ketë vendvotim dy minuta para mbylljes se vendvotimit ka hyre vëllai i Sami Lushtakut (kryetar i komunës se Skenderajit) i cili me anëtarët e AKR-ës kane pasur nga një laps kimik dhe çdo fletëvotim të zbrazët e kanë shënuar me votë për PDK-së

Parashtruesi i ankesës ka bashkangjitur si dëshmi deklaratat e vëzhguesve të LDK-ës Adnan Ferati, Edmond Kumnova dhe Burim Fejzullahu

Në raportin e policisë te datës 10.01.2011 te pollicit Sami Geci #7593 *thuhet se rrëth orës 23:55 ne vendvotim ka ardhur njësia e e hetuesis rajonale e cila i ka arrestuar dy persona (vëzhgues) e te cilët dyshohej se i kishin kërcënuar me herët vëzhguesit e LDK-së.*

Pas kërkesës se PZAP-it për informacione shtesë lidhur me raportin e lartcekur policia me raportin e saje shtese nr reference 2011-PK-S 010 të datës 12.01.2011 thuhet se ne shkollën fillore "Shote Galica" ne Runik ne QV 2114B është iniciuar një rast i kanosjes me nr 2011-BF-022 dhe nuk jepin sqarime se ndaj cilëve individ është iniciuar procedurë dhe duke mos përcaktuar as përkatësin e tyre partiakë.

Ndërsa për rastin e ankesës që ka të bëjë me vendvotimin 2101X ne shkollën e mesme Hamez Jashari ne Skenderaj theksojnë se çdo gjë ka qene në rregull, se nuk kane pranuar asnjë ankes nga komisionari i kësaj qendre apo ndonjë qytetar apo vëzhgues të ndonjë partie politike apo organizate tjeter jo qeveritare

Pas kërkesës shtese të PZAP-it për plotësim të raportit nga policia, policia në raportin e saje shtesë te datës 13.01.2011, konstaton se personat e arrestuar ditën e zgjedhjeve ne fshatin Runik janë Dan (Kadri) Durmishi nga fshati Kastriot dhe Burhan (Beqir) Smakaj nga fshati Runik.

Policia me tutje theksojne se pas kontaktit me personin zyrtar te KKZ-ës ne Skenderaj z Imer Ahmeti është konfirmuar se personat e lartshënuar nuk janë vëzhgues ose komisioner te asnjë partie dhe nuk figurojnë fare ne listat e tyre.

Neni 118 paragrafi 1 i LZP-së, parasheh:

*118.1 PZAP-i pranon ankesat e bazuara në fakte dhe refuzon ankesat të cilat nuk përmblushin standarde*

Rregullat dhe Procedurat e PZAP-it, neni 3 paragrafi 6 pika (c) parasheh si vijon:

*3.6 (c) hollësi rrëth qfarëdo dëshmi dhe kopje të qfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit ose udhëzime se ku mund të gjenden dëshmitë, në rastet kur të njëjtat nuk janë në posedim të ankuesit.*

PZAP-i pasi shqyrtoj dhe analizoi shkresat e lëndës gjeti se:

**- ankesa është e pabazuar**

Pretendimet nga parashtruesi i ankesës janë të pabazuara për shkakun se nuk është ofruar asnjë dëshmi apo prova të mjaftueshme për të besuar se kanë ndodhur shkeljet e pretenduar nga anëtaret e subjektit për te cilët pretendon ankuesi. Ky fakt konfirmohet nga raportet e lartcekura te policisë përmes te cilave nuk ka mundur qe te vërtetohet se a janë anetare, vëzhgues apo mbështetës te ndonjë partie politike.

Sipas nenit 32.1 te LZP-ës këtij kodi i detyrohen te gjitha subjektet politike, kandidatet, anëtaret e subjekteve dhe mbështetësit e tyre

Ndërsa sipas nenit 32.5 te LZP-ës ku thuhet se subjektet politike mbahen përgjegjëse për shkeljet e këtij kodi nga anëtaret, mbështetësit dhe kandidatet e tyre.

Nga raportet e lartcekura te policisë PZAP-i nuk ka mundur qe te vërtetoj se personat e arrestuar nga ana e policisë për kanosje ndaj vëzhguesve te LDK-ës, kane qene anëtarë, vëzhgues ose simpatizant te PDK-së.

PZAP-i duke u bazuar në arsyet e cekuara më lartë e po ashtu në pajtim më dispozitat e cituara ligjore si dhe në kuptim të nenit 115 paragrafi 1 të LZP-së, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

PZAP nuk do t'i pranojë kërkesat për ri-apelim, sepse vendimet e tij do të konsiderohen si përfundimtare. Prandaj, siç parashihet në Nenin 118.4 të LZP-së, *ankesa në Gjykatën Supreme të Kosovës mund të paraqitet brenda njëzetkatiër (24) orëve nga momenti i marrjes së vendimit nga PZAP-i, në rast se gjoba e përfshirë është më e lartë sesa pesëmijë (5, 000) Euro ose në rast se çështja prek një të drejtë themelore.*

#### Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresë

A nr. 61/2011 më datën 13.01.2011.

#### Kryesuesi i Panelit

